

ANEKSI IX

Ndryshimi i Kontratës së Koncesionit

të formës "BOT" për ndërtimin dhe administrimin e impiantit

të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut

Fier dhe prodhimin e energjisë

Në zbatim të Kontratës Koncesionare me Nr. Prot. 5553/5, datë 24.10.2016 "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë", e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k., mbi bazë të kërkesës së subjektit "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k., pikës 25 "Ndryshime" dhe mbi bazë të ligjit Nr. 125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 575, datë 10.07.2013, si dhe VKM Nr. 951, datë 28.12.2016 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi I projektit "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë"" si dhe:

- A. referuar Aneksit VII të Kontratës ku përcaktohet Plani dhe Koordinatat e sheshit ku do të realizohet ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin të energjisë.
- B. Meqënëse është ndryshuar sheshi për realizimin e objektit për të cilin është lidhur Kontrata Koncesionare dhe është miratuar VKM Nr. 951, datë 28.12.2016 "Për shpronësimin, për interes public, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi I projektit "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë"".

C. Në bazë të nenit 25.1 të Kontratës së Koncesionit sipas së cilës kjo Kontratë mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime për pjesët e negociueshme të procedurës referuar legjislacionit në fuqi, vetëm me marrëveshje të palëve, palët:

Ministria e Mjedisit e Republikës së Shqipërisë, në vijim "AUTORITETI KONTRAKTUES" e përfaqësues nga Ministri i Mjedisit z. Lefter Koka, Titullari i Autoritetit, shtetas shqiptar me ID _____, me adresë "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", nr. 27, Ish godina e ATSH-s, Tiranë.

DHE

Shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" sh.p.k. (SPV Integrated sh.p.k. NIPT L62205045F) me administrator z. Arenc Myrtezani, me seli qendrore ne Tiranë, me adresë Rr. "Ibrahim Rugova", Sky Toër, kati 13, zyra 13/2, me shtetësi shqiptare me ID _____ e krijuar nga bashkimi i operatorëve ekonomik "JV Integrated -Technology Service Sh.p.k & Energy 2 SRL Sh.p.k", në vijim "KONCESIONARI"

Vendosën dhe ranë dakord me ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Ndryshimin e Aneksit VII të kontratës së sipërcituar, ku përcaktohet Planit dhe Koordinatat e sheshit ku do të realizohej ndërtimi dhe administrimi i impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimit të energjisë, sipas Planit dhe Koordinatave të reja të sheshit, shpronësimi i të cilit është vendosur me anë të VKM Nr. 951, datë 28.12.2016 "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarit të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë", përkatësisht lidhja nr. 1 e VKM-s së sipërcituar "Listë e pronave të pasurisë pronë private që do të shpronësohen për efekt të realizimit të projektit për interes public "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë"



Neni 2

Në zbatim të ndryshimit të cituar në Nenin 1 mësipërm, këtij aneksi I bashkëlidhet si pjesë përbërëse dhe e pandashme e Kontratës Koncesionare me Nr. Prot. 5553/5, datë 24.10.2016 "Për ndërtimin dhe administrimin e impiantit të trajtimit të mbetjeve urbane të Qarkut Fier dhe prodhimin e energjisë", e lidhur ndërmjet Ministrisë së Mjedisit dhe Shoqërisë "Integrated Technology Waste Treatment Fier" Sh.p.k., Plani dhe Koordinatat e sheshit të ri të ndërtimit të impiantit.

Neni 3

Kopjet e hartuara

Ky aneks Kontrate, hartohet në gjuhën shqipe në 3 (tre) kopje të cilat kanë të njëjtën vlerë ndërmjet tyre.

Neni 4

Hyrja në fuqi

Ndryshimi i kontratës (Aneksi IX) do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga palët përpara noterit publik në përputhje me pikën 32 të Kontratës së koncesionit dhe bëhet pjesë e pandarë e Kontratës së koncesionit në zbatim të paragrafit 25.2 të kësaj Kontrate.

Për: MINISTRINË E MJEDISIT

Z. Lefter KOKA

Për: "Integrated Technology Waste

Treatment Fier" sh.p.k.

Z. Arene MVRTEZANI

ADMINISTRATOR